



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK**

Nr 1142 Prot

B.Curri me. 07.03 2022

VENDIM

Nr 25 Date 28.02.2022

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, në zbatim të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1\1 shkronja "b", nenit 24 dhe nenit 54 shkronja "dh" dhe nenit 55 pika 3 dhe 6 të Ligjit nr.139\2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; nenit 113 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjit Nr.9936 Date 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin Nr. 79 "Per Sportin" neni 19; VKB-së Nr.111, datë 24.12.2021 "Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2022, si viti i parë i PBA-së 2022-2024" si dhe kërkesen e shoqates "Klubi i Shahut Valbona" nr 4613 prot dt 03.12.2021 , protokolluar pranë Bashkisë Tropojë.

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin 500.000 (peseqind mije) lekë për shoqaten "Klubi i Shahut Valbona" per zhvillimin e turneve ne sportit te shahut .
2. Burimi i financimit te jete 300.000 (treqind mije) nga te ardhurat e krijuara dh 200 000 (dyqind mije) nga buxheti i Bashkise Tropoje per vitin 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë)ditë pas shpalljes.

Për Këshillin Bashkiak Tropojë:

Sekretar
Ergent GJONGECAJ

Shpallur me 07.03.2022
Miratuar me 15 vota
Vota Pro 15
Vota Kunder 0
Vota Abstenim 0

